



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

NJOFTIM PËR POZICION VAKANT

“Specialist Prokurimesh”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “**Ekipe Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kondidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “**Specialist Prokurimesh**”

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Detyrat e Specialistit të Prokurimeve

Specialist i Prokurimeve, nën mbikqyrjen e Drejtorit të Projektit dhe Shefit të Financës, do të jetë përgjegjës për gjithë procesin e prokurimit në kuadër të projektit “Ekipe Sportive 2022”. Për të përmbushur objektivat e caktuara Specialisti i Prokurimeve duhet të kryejë detyrat si më poshtë:

- Oranizon të veprimtarinë e punës në sektorin e prokurimeve dhe raporton drejtpërdrejt te Drejtori i Projektit dhe Presidenti i KOKSH.





Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

- Organizon punën në hartimin e dokumenteve të tenderit, duke kontrolluar ligjshmërinë e kërkesave të caktuara në to.
- Harton dosjen e tenderit. Duke përfshirë urdhërin e prokurimit dhe urdhërin për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe pas miratimit nga titullari i institucionit, merr masa për vënien në dispozicion të anëtarëve, të dokumenteve të tenderit për prokurimin që kryhet.
- Përgatit relacione dhe informacione periodike lidhur me mbarëvajtjen e punës dhe bën propozime konkrete për zgjidhjen e problemeve të hasura, duke respektuar legjislacionin në fuqi.
- Merr pjesë dhe monitoron përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, në rast kur kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.
- Është përgjegjës për dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore lidhur me të gjitha procedurat e prokurimit.
- Është përgjegjës për të gjitha veprimet në sistemin online të APP.
- Me përfundimin e procedurave të tenderit, dorëzon dokumentacionin përkatës në arkivin e KOKSH, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga epërori.

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Të ketë përfunduar Fakultetin Ekonomik apo Juridik, DNP (Diplomë e nivelit të parë) + Master, ose DIND (Diplomë e integruar e nivelit të dytë);
- Të paktën 2 vite eksperiencë profesionale në fushën e prokurimeve publike;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze.



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Të ketë aftësi shumë të mira koordinuese, organizative dhe komunikuese;
- Të ketë aftësi shumë të mira shkrim dhe arsyetim ligjor;
- Të zotrojnë në nivel shumë të mirë "Paketën Office";
- Aftësi bashkëpunuese në grup.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 12 Maj 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al, me subjekt: **Aplikim për pozicionin Specialist Prokurimesh "Ekipet Sportive 2022"**.

